

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -VIII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 SHTATOR 2019**

Mbledhia është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Rrezarta Krasniqi, Hysni Gërguri, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rustemi Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – njoftoi kuvendin se nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zyrtarisht kanë aderuar në PDK dy asamblistë z. Basri Menxhiqi dhe znj. Teuta Aruçi- Shartari dhe se nga sot do të jenë pjesë e grupit kuvendar të PDK-së. Lidhur me fushatën paraelektorale apeloj tek të gjitha subjektet politike që të kemi një garë fer dhe pavarësisht se në cilën parti kemi kandidatë për deputetë kërkoj nga qytetarët që të përkrahin deputetët nga Komuna e Vushtrrisë.

**Hajriz Mustafa anëtar i kuvendit** - njoftoi se nga sot i është bashkuar grupit kuvendar të LVV-së, në këtë rast uroi suksese dhe punë të mbarë në kuvendin e komunës.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** - fillimisht iu uroj suksese kandidatëve në garë për deputetë në Kuvendin e Kosovës. Tutje pyeti lidhur me premtimin për rritje të subvencioneve për klubet

sportive, gjë kjo e cila nuk ka ndodhur. Pastaj shtoi se ka pasur diskriminim për disa klube siç është Klubi të hendbollit “Samadrexha” i cili është një klub me renome ndërkombëtare, dhe i cili për herë të parë ka përfaqësuar Kosovën në gara ndërkombëtare me flamur, por këtij klubi i janë ulur subvencionet dhe për këtë ka pasur protesta nga banorët lokal. Për këtë pyeti se përse ka ndodhur kjo. Gjithashtu edhe tek shoqata e peshkatarëve nuk ka pasur subvencione për këtë shoqatë dhe për më keq, një hapësirë e dedikuar për peshkim, është shndërruar nga komuna në deponi mbeturinash për Kompaninë “Uniteti”, për këto kërkoi përgjigje.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - kërkoi nga drejtorët e drejtorive komunale, që për çdo pikë të rendit të ditës të bëhet nga një rezyme, kjo me qëllim që qytetarët të kenë një pasqyrë lidhur me pika që diskutohen në kuvend dhe për vendimet që merren.

***Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me 21 vota “për” aprovoi këtë:***

### R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.7.2019;
  2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2020;
  3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2019;
  4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për realizimin e të drejtave, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (**shqyrtimi i parë**);
  5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zona kadastrale Maxhunaj);
  6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale (Zona kadastrale Gracë);
  7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2019/2020;
  8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike;
  9. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrje – shirjeve;
  10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për vitin 2018;
  11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, për vitin 2018;
  12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit;
  13. Të ndryshme.
    - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica” SH.A.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.7.2019

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.7.2019.***



## 2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2020

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - në adresimin e tij para kuvendit tha se është i kënaqur që prezanton një buxhet të ekuilibruar në aspektin fiskal për vitin 2020 para Kuvendit Komunal dhe qytetarëve të Vushtrrisë. Buxheti i qytetit është një plan fiskal që përcakton të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikat që zbatohen gjatë vitit fiskal 2020. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e komunitetit tonë. Buxheti i propozuar do të vazhdojë të arrijë prioritetet afatmesme të komunës siç janë aprovuar në qershor të vitit 2019 me Kornizën Afatmesme të Buxhetit 2020-2022. Ju do të shihni se këtyre prioritetëve do t'i referohem përgjatë këtij dokumenti. Për më tepër, buxheti i propozuar reflekton kryesisht në kërkesat e qytetarëve, të paraqitura gjatë dëgjimeve publike buxhetore, të organizuara nga stafi im gjatë periudhës së dëgjimeve buxhetore. Buxheti i vitit 2020 pasqyron përpjekjen tonë të vazhdueshme për të ofruar shërbime arsimore cilësore në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm, shërbime shëndetësore dhe barnave nga lista esenciale, si dhe zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës. Për të zbatuar prioritetet e mësipërme, buxheti për vitin fiskal 2020 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale si: buxhet dhe financa; administrata dhe personeli; inspektive; planifikimi urban dhe mjedisi; shërbimet sociale dhe rezidenciale, gjeodezi dhe kadastër; bujqësi, pylltaria dhe zhvillim rural; kulturë, rini dhe sport; shërbime publike, shëndetësi dhe mirëqenie sociale; arsimi dhe shkenca; zyra komunale dhe komunitete dhe prokurimi. Programet e komunës vazhdojnë të pasqyrojnë qëllimin tim për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve tanë, shoqëruar me një menaxhim të shëndoshë dhe konservator financiar. Të ardhurat e parashikuara të komunës për vitin 2020 janë të qëndrueshme, me një rritje të përgjithshme buxhetore prej 4% krahasuar me vitin e kaluar. Kjo do t'i lejojë komunës të mbajë të qëndrueshme shpenzimet dhe të financojë nisma dhe projekte të reja të rëndësishme si ndërtimi i një shkolle në fshatin Stanoc i Epërm, ndërtimi i shkollës së muzikës dhe ndërtimi i një kopshti, si investime kryesore në arsim, së bashku me investime të mëdha në kujdesin shëndetësor siç është ndërtimi i qendrës mjekësore familjare. Jam i interesuar për zbatimin e projekteve shtesë, të rëndësishme për qytetarët e Vushtrrisë, siç është ndërtimi i një sistemi të ujërave të zeza, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, ndërtimi i shtratit të lumit në "Podrança", ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe ndërtimi i një tregu të prodhuesve vendorë. Ndërtimi i rrugëve në qytet dhe fshatra mbetet përparësia ime për vitin 2020. Procesi i buxhetit për vitin financiar 2020 është mbështetur nga partneri ynë afatgjatë USAID, përmes projektit të tij TEAM, duke adresuar interesin tonë për përmirësimin e proceseve të brendshme, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve tanë. Mund ta vëreni se shpalosja e buxhetit dhe prezantimi për vitin financiar 2020 përcakton një standard tjetër për Vushtrrinë, krahasuar me vitet e kaluara, por edhe për pjesën tjetër të komunave të Kosovës. Unë angazhohem për reforma, të cilat do ta bëjnë komunën tonë një model për pjesën tjetër. Në fund, unë i inkurajoj të gjithë të shohin këtë buxhet si një shprehje të vlerave tona dhe vizionit tonë për të ardhmen. Ky buxhet i vë të parët qytetarët e komunës sonë. Falënderoj secilin që ka marrë pjesë në përgatitjen e këtij buxheti, përfshirë komunitetet lokale për propozimet e tyre të vlefshme.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime lidhur me tabelat buxhetore, ku njoftoi se është bërë një përmirësim i tabelave financiare, pasi Drejtoria e Shëndetësisë ka bërë kërkesë për blerjen e një automjeti për terren dhe ndryshimi tjetër është bërë tek projekti Shtëpia për qëndrim ditor të pëlqeve ku shuma e mjeteve është rritur nga 20,000.00 € në 60,000.00 €. Gjithashtu kërkesa e Komitetit për Politikë dhe Financa për blerjen e lap-top-ve është futur në buxhetin e vitit 2020.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se pas konsultimeve që kanë pasur me grupin e tyre kuvendar, kanë ardhur në konkludim se buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020 nuk i ka atributet e një buxheti zhvillimor dhe nuk i kontribuon zhvillimit ekonomik të komunës. Tek tabela 4.2 investimet kapitale, kodi ekonomik 41415, pozicioni ndërtimi i kanalizimeve janë planifikuar 200,000.00 € pa pasur një kërkesë të qartë një paramasë dhe parallogari. Pastaj tek nënkodi 47826 ndërtimi i stacionit të autobusëve janë paraparë 250,000.00 €, madje 220,000.00 € nga të hyrat vetanake dhe këtu shihet ajo dinakëria dhe joserioziteti i kësaj qeverie, për faktin se gjithë këtë shumë të mjeteve financiare e ka planifikuar nga të hyrat vetanake për një projekt për të cilin nuk ka kurrfarë përgatitjesh e madje as lokacioni për ndërtimin e tij nuk është caktuar, ndërsa vetëm 30,000.00 € janë ndarë nga granti. Edhe më keq është bërë planifikimi tek kodi i programit 46628 zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit ku janë planifikuar të shpenzohen për këtë projekt 500,000.00 €, dhe këtu shihet dështimi i madh i kësaj qeverie, për faktin se për këtë projekt Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka planifikuar mjete për këtë projekt, në vlerën prej 600,000.00 €, por neglizhenca e kësaj qeverie komunale ka bërë që këto mjete të mos investohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Mjedisit. Për t'u bërë kjo punë akoma më keq, qeveria komunale ka shpallur aktivitetin e prokurimit e mbase edhe është përzgjedhur operatori ekonomik për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, duke kontraktuar që t'i gjobisë qytetarët, duke paguar nga 80 € për kyçje individuale të secilës ekonomi familjare. Andaj duke i marr për bazë të gjitha të cekurat më lartë dhe mangësitë tjera, të cilat nuk dëshiron t'i shpalos për shkak të fushatës paraelektorale, njofton se grupi kuvendar i PDK-së nuk do ta përkrah me votë aprovimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - njoftoi se krerët e komunës nuk kanë pasur ftesë nga zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit për t'i nënshkruar mjetet financiare lidhur me projektin e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - tha se grupi kuvendar i LDK-së, i jep mbështetje të plotë draft-buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për faktin se ky buxhet bazohet në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë dhe është një buxhet i ekuilibruar.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - lidhur me listën e rrugëve për asfaltim sipas kërkesave për planifikim për vitet 2020-2021-2022 të paraqitur në kuvend, në këtë kontekst pyeti se cilat janë rrugët që do të ndërtohen gjatë vitit 2020, a janë të caktuara ato rrugë, apo ato do të ndërtohen sipas prioriteteve, apo do të vazhdohet sipas avazit të vjetër sipas individëve të caktuar.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së** - sqaroi se të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët për asfaltim të rrugëve, nga shtatori i vitit të kaluar e deri në këtë moment janë inkorporuar në këtë listë pa dallim, dhe për këtë çështje është formuar komisioni prej tre anëtarëve nga Drejtoria e Urbanizmit, në këtë rast edhe vitin e kaluar, por edhe këtë vit do të bëhet verifikimi në terren i gjendjes së rrugëve, do të caktohen parametrat mbi bazën e të cilëve do të bëhet selektimi i

ndërtimit të rrugëve, dhe prioritizimi i tyre. Në fund tha se kjo metodë e të vepruarit është lavdëruar nga USAID - i dhe ngjashëm në këtë procedurë do të veprohet edhe në këtë vit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se kjo listë rrugësh është një fontanë dëshirash, pasi mjetet e planifikuara financiare nuk janë të mjaftueshme për t'i ndërtuar të gjitha këto rrugë. Kjo i bie që në një lokalitet apo fshat do të planifikohet ndërtimi i 7 rrugëve e në realitet do të ndërtohet një rrugë apo nuk do të ndërtohet asnjë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se lista për ndërtimin e rrugëve me asfalt, është pjesë e buxhetit të komunës për vitin 2020, dhe brenda mundësive financiare që lejon buxheti do të realizohet projekti për ato rrugë që kanë më së tepërmi prioritet. Buxheti për vitin e ardhshëm është i fokusuar tek ujësjellësi, kjo i bie që mjetet janë hequr nga asfalti dhe janë orientuar në rrjetin e ujësjellësit, ku në vitin 2020 janë planifikuar 500,000.00 € të dedikuara për kyçjet individuale, ndërsa kemi 200,000.00 € tek asfaltimi i rrugëve, dhe kjo tregon se prioritet i kësaj qeverie është uji i pijshëm për qytetarët. Lidhur me marrëveshjen për ndarjen e mjeteve për komunën nga Ministria e Mjedisit, ai i siguroi të gjithë qytetarët se nuk ka të bëjë me kurrfarë neglizhence të komunës sa i përket këtyre mjeteve dhe se e vërteta është se si komunë i kanë siguruar ato mjete në buxhet përmes Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kanë hyrë 600,000.00 € dhe atë 300,000.00 € në vitin 2019 dhe 300,000.00 € për vitin 2020. Në këtë kontekst ai sqaroi para kuvendit se në adresimin dhe komunikimin zyrtar që ka pasur gjatë muajit mars dhe korrik të këtij viti, me ministrin e Ministrisë së Mjedisit ky i fundit nuk ishte përgjigjur, dhe se është fakt se nuk ka pasur kurrfarë ftese për nënshkrim të dokumentit për mjetet për ujësjellësin. Për sa i takon pagesës së qytetarëve për kyçje në rrjetin e ujësjellësit, njoftoi se Kompania e ujësjellësit ka një tarifë prej 125 € për kyçje në rrjet, njësoj siç është tarifa e KEDS-it. Komuna praktikisht me projektin e kyçjeve individuale po e zvogëlon këtë shumë nga 120 € në 80 € dhe po ashtu po e kryen pjesën e punës, duke përfshirë orët dhe pusetat për kyçje individuale të ekonomive familjare, kurse kjo është arritur duke u bazuar në një memorandum me ujësjellësin dhe duke pasur parasysh zotimin që ka pasur qeveria e kaluar që investimet për kyçjet individuale të bëhen nga mjetet e komunës pasi CDI-ja zvicerane dhe Qeveria e Kosovës kanë investuar në rrjetin primar dhe sekondar në ujësjellës deri më tani. Pra ky është një projekt që po rumbullakoset dhe tani janë 9,000 familje që do të kyçen në rrjetin e ujësjellësit me këtë projekt në Qytetin e Vushtrrisë. Nga këto familje 3,000 lirohen nga pagesa, e në këtë rast janë familjet e dëshmorëve, të veteranëve të UÇK-së, familjet e martirëve dhe familjet me asistencë sociale, dhe për këtë është dashur që shuma nga 60 € të rritet në 80 € me qëllim që të mbulohet pjesa e mjeteve financiare për rastet- familjet, të cilat janë liruar nga pagesa të cilat u cekën më lartë. Këtu po shihet se edhe me paratë e komunës po investohet në kyçjet individuale në rrjetin e ujësjellësit ashtu siç ka qenë zotimi i tyre. Kjo do të bëhet gjatë këtij viti, por intensiteti i zhvillimit të këtij projekti do të rritet sidomos gjatë vitit të ardhshëm ku është buxheti më i madh. Në fund tha se nëse ka shkresë zyrtare nga sekretari permanent në Ministrinë e Mjedisit, atëherë ai është i gatshëm që ta nënshkruajë menjëherë marrëveshjen për këtë projekt.

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se kur bëhet fjalë për buxhetin e komunës për vitin 2020, Partia e Drejtësisë parimisht është pro këtij buxheti, por kërkoi që ky buxhet të jetë gjithëpërfshirës. Tek planifikimi urban dhe mjedisi, kodi 41424 asfaltimi i rrugëve në fshatra janë paraparë 470,000.00 €, në këtë kontekst kërkoi që të futet në buxhet asfaltimi i rrugës "Bekë Galica" në fshatin Galicë, në gjatësi prej 300 metra, për shkak të nevojës imediate të rregullimit të kësaj rruge.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - tha se me qëllim të shmangies së keqklasifikimit të buxhetit, projektet në bujqësi janë furnizuar në një projekt të vetëm, me titull <Projekti për zhvillimin e

bujqësisë në bashkëfinancim>, për këtë kërkoi përkrahjen e kuvendit që nëse kjo pikë nuk kalon të kemi të drejtë t'i bartim mjetet në projektet tjera aktuale.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se kërkesa e drejtorit të DBF-së është deri diku objektive, por nuk është e sigurt se kemi të drejtë t'i bartim mjetet në formën se si ai propozon. Pastaj shtroi çështjen e projektit <Ndërtimi i objektit për familjet e dëshmorëve>, për faktin se mjetet janë në buxhet, por për këtë projekt nuk janë paraparë mjete financiare dhe akoma nuk është filluar me këtë projekt, në këtë relacion kemi mospunë dhe mosorganizim. Pastaj shtoi se në këtë buxhet nuk janë projeksionet që ndikojnë në zhvillimin e qytetit, kemi mosdakordancë mes qeverisë lokale në njërin anë dhe me qeverinë qendrore në anë tjetër. Andaj si rezultat i kësaj tha se do ta votojmë kundër këtë buxhet.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se është e vërtetë se LDK-ja vetëm njëherë nuk e kishte votuar buxhetin e komunës në kohën kur komunën e drejtonte PDK-ja, dhe atë për faktin se tri vite kishte pasur kërkesë për dy projekte, rregullimi i lumit "Podrança", për faktin se ky lumë kishte vërshuar disa herë lagje të tëra, dhe edhe përkundër kërkesës së LDK-së, ky projekt nuk ishte inkorporuar në buxhet, ndërsa projekti tjetër ishte rregullimi i rrugës së Sllatinës edhe përkundër fitimit të kontestit gjyqësor nga komuna, kjo rrugë nuk ishte rregulluar, ani se kishte pasur deklarime se posa të inkasohen mjetet nga ai kontest gjyqësor ajo rrugë do të rregullohet, por një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Andaj kjo ka qenë arsyeja e vërtetë se përse nuk e kishin votuar buxhetin.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - pyeti se në cilin vit është aprovuar buxheti për rregullimin e lumit "Podrança", pyetja i drejtohet kryetarit të komunës, drejtorit të urbanizmit apo drejtorit të financave.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se mjetet financiare për rregullimin e lumit "Podrança" janë planifikuar në vitin 2017 për buxhetin e komunës për vitin 2018, dhe atë me një shumë simbolike nga të hyrat vetanake në vlerë prej 50,000.00, ndërsa shuma totale e këtij projekti është mbi 200,000.00. Andaj në këtë kontekst vlerësoi se akuzat e mëhershme se planifikimi i buxhetit nga të hyrat vetanake për projektet kapitale, është përdorur si taktikë për mosrealizimin e projekteve janë të pasakta dhe të paqëndrueshme.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** - tha se kërkoi përgjigje të sinqertë dhe nuk dëshiron të bëjë politikë në kohë fushate me askënd e sidomos me kryetarin e komunës, duke i adresuar se nuk dëshiron të polemizojë me të sepse është duke e kursyer dhe këtë ai e di sepse nuk dëshiron të marr kah tjetër.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se planifikimi i projektit, rregullimi i lumit "Podrança" ka qenë në buxhetin e vitit 2016 për t'u realizuar në vitin 2017, edhe për këtë përsëriti se ka qenë kërkesë e LDK-së për tri vite rresht, por kjo nuk ndodhur.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2020-2022, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2020 dhe 02/2020 të lëshuara nga MF-ja.
2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020 është 19,939,966.00 €, prej të cilave për:



|                              |                |
|------------------------------|----------------|
| 2.1 Paga dhe mëditje.....    | 11,400,130.00  |
| €                            |                |
| 2.2 Mallra dhe shërbime..... | 3,211,496.00 € |
| 2.3 Shpenzime komunale.....  | 309,035.00 €   |
| 2.4 Subvencione.....         | 292,914.00 €   |
| 2.5 Shpenzime kapitale.....  | 4,726,391.00   |
| €                            |                |

Gjithsej:.....19,939,966.00 €.

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....2,035,660.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2020 dhe 02/2020 të MF-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2020-2022; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2019-2021; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës për vitet 2020-2022, si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2019

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi Raportin për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershor 2019.*

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për realizimin e të drejtave, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (shqyrtimi i parë)

Remzije Zekolli, zyrtare për drejtat e njeriut - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me Draft-rregulloren për realizimin e të drejtave, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Realizimin e të Drejtave, Mbrojtjen dhe Parandalimin e Punëve të Rënda për Fëmijë.

2. Diskutimi publik fillon nga data 1 tetor 2019 dhe zgjat deri më 1 nëntor 2019.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet komisioni hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin tetor 2019.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale (Zona kadastrale Maxhunaj)

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se e ka përsëritur edhe më herët dhe apelon edhe tani, që nuk është mirë dhe nuk duhet që prona komunale të jepet në shfrytëzim gjatë kohës së fushatës paraelektorale. Pastaj bëri vërejtje tek drejtori i Drejtorisë së Kadastrit, i cili në mënyrë të përsëritur jep arsyetim të njëjtë me shkrim për të gjitha pronat, e që siç dihet secila pronë i ka specifikat e veta. Andaj ai kërkoi që në të ardhmen duhet të jepen arsyeime të bazuara dhe konform kriterëve të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202046-00880-0 me sipërfaqe prej 17215m<sup>2</sup>, ZK Maxhunaj, në afat prej 15 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për zhvillimin e aktiviteteve sportive-terrene sportive.

2 .Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale (Zona kadastrale Gracë)

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi kuvendin, se pas ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur në Ligjin për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim, kryetarit të komunës i është dhënë mundësia që të zhvillojë negociata me investitorët potencial, por kushti ligjor është që pronat komunale duhet të jenë të publikuar në listë për dhënien e tyre në shfrytëzim. Pastaj sqaroi se ka një interesim nga një investitor kroat dhe spanjoll, bashkë me një investitor vendor, për të hapur një fabrikë që do të punësonte deri në 200 punëtorë (gra). Në fund tha se ky është hapi fillestar në këtë drejtim, ndërsa për hapat tjerë do të informohet me kohë kuvendi, andaj ftoi që ky propozim-vendim të mbështet me votë nga kuvendi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202022-00512-1 me sipërfaqe prej 53693 m<sup>2</sup>, ZK Gracë, në afat prej 40 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.

2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

3. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2019/2020

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar informatës në fjalë, ceku se nëpër shkollat fillore, nxënësit gjatë pushimit të gjatë dalin jashtë oborrit të shkollës, dhe kjo dukuri paraqet rrezik për nxënësit, si nga veturat ashtu edhe nga fakti se këtyre nxënësve gjatë kësaj kohe u jepet mundësia që të konsumojnë cigare e ndoshta edhe ndonjë substancë tjetër. Lidhur me këtë ai pyeti se kujdestari i ditës a duhet të ketë nën mbikëqyrje vetëm objektin shkollor apo edhe sjelljet e nxënësve gjatë ditës kur ai kujdestaron. Pastaj shtoi se në gjitha vendet mësimdhënësit para fillimit të mësimi i presin nxënësit, tek ne është e kundërta nxënësit i presin mësimdhënësit gjë kjo jo në rregull, pasi kësaj mund të shfaqen probleme dhe parregullsi të ndryshme. Ai kërkoi nga drejtori kompetent që në mbledhje me drejtorët e shkollave t'i zgjidhë këto probleme.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se Ministria e Arsimit në saje të një vendimi ka zgjatur minutazhën e orës mësimore nga 40 minuta në 45 minuta për të gjithë nivelin e arsimit

parauniversitar, kjo ka shkaktuar disa çrregullime sidomos në orarin e pasdites, pasi që ora e fundit e mësimit përfundon në ora 18:35, dhe kjo po iu shkaktonte problem nxënësve të cilët udhëtojnë, për faktin se kompanitë transportuese të kontraktuara nisen para kësaj kohe me automjetet e tyre dhe nxënësit kështu kanë vështirësi në udhëtim. Gjithashtu ai përgëzoi qeverinë komunale për fillimin e furnizimit të nxënësve me kiflet, gjë kjo që ka krijuar një barazi mes nxënësve. Ai sugjeroi që në të ardhmen të mendohet që në planifikimin e buxhetit të ndahen mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit e shkollave të mesme.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së** - në përgjigjet e tij për anëtarët e kuvendit, ceku se në të kaluarën është provuar që gjatë pushimit të gjatë të nxënësve të mbyllen dyert e oborrit të shkollës kjo p.sh është provuar në shkollën fillore SH.M.U.2, por një praktikë e tillë nuk është pranuar nga ana e prindërve nën arsyetimin që fëmijët duhet të ushqehen gjatë kësaj kohe. Nga ky vit është filluar me nxënësit parafillorë dhe fillorë që t'u krijojmë kushte që ata të ushqehen brenda lokaleve shkollore, ashtu që ata fare mos të dalin jashtë objektit të shkollës gjatë orarit të mësimit. Mandej njoftoi se gjatë takimeve që kanë pasur me kryetarin dhe drejtorët e drejtorive ka kërkuar nga inspektorati që t'i kenë nën vëzhgim lokalet që shesin gjëra ushqimore afër shkollave, ashtu që të kemi njohuri se çfarë konsumojnë nxënësit tanë. Lidhur me çështjen e kujdestarisë nëpër shkolla nga mësimdhënësit nuk është ajo se çfarë dëshirojmë të kemi, por ajo është deri diku në nivel. Zgjatja e minutazhit të orëve mësimore nga 40 në 45 minuta është vendim i kryeinspektorit që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit, dhe sa i përket udhëtimit të nxënësve njoftoi se ka biseduar me të gjitha kompanitë kontraktuese për harmonizimin e orarit të nisjes së mjeteve të udhëtimit ashtu që ajo të jetë në harmoni me përfundimin e orarit mësimor të nxënësve dhe këtu nuk ka vend për shqetësim.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se ideja e sigurimit të shujtave për nxënësit, ka qenë i ide e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe ky shembull i mirë është ndjekur edhe nga të tjerët. Tutje shtoi se një pjesë e grave që kanë punuar për hapjen e bufeve nëpër shkolla, ato tani kanë mbetur keq, pas shpërndarjes së shujtave për nxënës nga ana e komunës, pasi ato i kanë humbur klientët e tyre. Në këtë kontekst kërkoi që këtyre grave t'u ofrohet ndihmë ashtu që të mund ta sigurojnë klientelen që e kanë pasur dikur dhe të sigurojnë vetëpunësim.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se më qëllim që t'u dilet në ndihmë këtyre grave të vetëpunësuar, komuna ka marrë vendim që lokalet të cilat i kanë shfrytëzuar për ofrimin e shërbimit të gatimit për nxënësit, iu është hequr qiraja e atyre lokaleve.

**8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike**

**9. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrje – shirjeve**

**10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për vitin 2018**

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** - e përgëzoi këtë komitet për raportin e ofruar në kuvend, dhe shtoi se vizita në QMF-Pantinë, problemet që kanë qenë me rrjetin e ujësjellësit dhe çezmet janë kryer. Mandej oborri i QMF-së është i mirëmbajtur dhe është rregulluar plotësisht.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për” aprovoi raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për vitin 2018.**

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, për vitin 2018

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për” aprovoi raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta, për vitin 2018.**

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për” aprovoi raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.**

13. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica” SH.A.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - propozoi që vendimi i mëhershëm për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim të shfuqizohet, e pastaj të merret vendimi tjetër për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim sipas vlerësimit të bërë nga ministria e linjës, d.m.th të kemi ndarje të kësaj çështjeje gjatë vendosjes së saj.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - konstatoi se këtij vendimi i shtohet një pikë, me të cilën shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01-245/19 i aprovuar më datë 25.7.2019, të cilin Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e kishte vlerësuar se ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 20 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë në ngastrën kadastrale nr.P-70202046-01033-0, Zona Kadastrale Maxhunaj pronë e Komunës së Vushtrrisë, me kulturë kullësë e klasës së dytë (2), sipërfaqe prej 4434m<sup>2</sup> ku nga sipërfaqja e përgjithshme jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 210.00m<sup>2</sup>.

2. Prona e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica” Sh.A për ndërtimin e rezervuarit nëntokësor me vëllim V=180.00m<sup>3</sup> apo dimensionet (12.40X6.50m) sipas projektit të prezantuar, objekti me rrethojë i cili do të shfrytëzojë hapësirën prej 210.00m<sup>2</sup>.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01-245/19 i aprovuar më datë 25.7.2019, të cilin Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e kishte vlerësuar se ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.



5. Pjesë e këtij vendimi janë: certifikata e pronësisë, kopja e planit dhe skicat e projektit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - njoftoi kuvendin se Drejtoria për Buxhet dhe Financa nuk e ka ofruar për shqyrtim Draft-rregulloren e Tatimit për Pronën e Paluajtshme, pasi ministria e linjës ende nuk i ka përfunduar vlerësimet e pronës rezidenciale.


**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për mbështetjen e dhënë për aprovimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020, por edhe për pikat tjera të rendit të ditës. Në fund ai i uroi të gjithë kandidatët e partive politike nga Komuna e Vushtrrisë që janë kandidatë për deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke iu dëshiruar që ata të marrin besimin qytetar për ulëse në kuvendin e republikës, ashtu që ata të jenë zëri i fuqishëm i përfaqësimit të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë dhe adresimit të problemeve të tyre.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35.

**Bastri Duraku**

  
Procesmbajtës

**Nasuf Aliu**

  
Kryesues i Kuvendit